

TAKSAT NGRIVA, SHIKRIVA

00%
15% TATIM MBI FITIM

RAPORT MONITORIMI

Mars 2024

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
KOLINDO VJERDHA

TABELA E PËRMBAJTJES:

1. Hyrje
2. Panorama e gjendjes së sistemit fiskal shqiptar
3. Risitë e që sjellin dispozitat e reja ligjore
4. Efektet e ndryshimeve mbi detyrimet tatimore
5. Akti Normativ që ndryshoi zbatimin e ligjit
6. “Profesionet e lira”, të varurat e programeve politike
7. Ndikimi i dispozitave të reja ligjore në numrin e të vetëpunësuarve
8. Ndryshimet ligjore në këndvështrimin e subjekteve
9. Përfundime dhe rekomandime
10. Bibliografia



15% TATIM MBI FITIM

Hyrje

Në këtë raport analizohen sfidat e reja të krijuara nga ndryshimet në trajtimin ligjor të subjekteve të prekura nga ligji i tatimit mbi të ardhurat personale. Analiza detajohet në efektet e vëzhguara nga ana fiskale e të gjitha subjekteve, veçanërisht të atyre që janë bërë tashmë pjesë rishtazi e skemës së re.

Raporti sjell një panoramë të ndikimit që do të kenë këto skematizime të reja si në spektrin e individit si subjekt, profesioneve të lira, por edhe në përfitueshmërinë që rrejdhon drejtpërdrejt në buxhetin e shtetit.

Bazuar edhe në evidentimet e kryera nga monitorimi i procesit do sillen gjithashtu rekomandime rreth menaxhimit të barrave fiskale të reja që krijohen mbi këtë treg, gjithashtu duke analizuar nga ana konceptuale këtë vendimmarrje e cila prek një shtresëzim social që mundohen të kontribuojnë si të pavarur nga struktura të veçanta.

Panorama e gjendjes së sistemit fiskal shqiptar

Ndryshimet ligjore në ligjin për tatimin mbi të ardhurat u argumentuan që në projektligjin e propozuar në komisionet përkatëse dhe në parlament si një mundësi për minimizimin e keqinterpretimeve ligjore, uljen e evazionit, informalitetit dhe nxitjen e iniciativave të reja të biznesit.

Problematika evidente në sistemin fiskal shqiptar vazhdon të mbetet evazoni, kjo e nënvizuar edhe në raportin e publikuar të Departamentit të Shtetit për vitin 2023. Kjo dëmton mbi të gjitha konkurrencën në treg dhe nxit pabarazinë ndërmjet subjekteve që operojnë.

Që në vitin 1998 ka patur ndryshime të vazhdueshme në këtë ligj të cilat janë përshtatur jo vetëm me kushtet e reja të tregut, por edhe me etapat e zhvillimit ekonomik. Në të gjitha këto faza që ka kaluar ekonomia është mundur gjetja e stimujve të rinj fiskal që të ndihmojnë zhvillimin normal të indikatorëve përcaktues ekonomik dhe të një klime normale që nxit zhvillimin e biznesit.

Referuar Ministrisë së Financave argumentohet se arsytet reale të cilat çuan në ndryshimet e fundit ligjore lidhen me dukurinë e “erozionit” të listepagesave të tatimpaguesve për kategoritë që bëjnë pjesë në ato që cilësohen si profesione të lira. Rezulton se këto profile profesionale regjistroheshin si person fizik duke u pajisur me NIPT dhe ofronin shërbimet e tyre në kompanitë që më parë kanë qënë të punësuar duke nxjerrë në këtë formë veten rrjedhimisht nga listpagesa e tyre. Në këtë formë nga njëra anë individi shmangte tatimin mbi të ardhurat nga punësimi ndërsa nga ana tjetër biznesi merrte fatura shpenzimesh të cilat janë të njohura, me qëllim pagimin e një tatimi më të ulët.

Mbështetësit e ndryshimeve ligjore arsyetojnë se këto rikategorizime të subjekteve të cilat kthehen në detyruese nga tuj janë një formë parandalimi ndaj kësaj skeme evazioni e cila kishte krijuar shmangës të detyrimeve, por që në fakt procedurat e ndjekura ishin komform ligjit në fuqi.

Nëse do e vazhdojmë të njëjtën logjikë mbi të cilën argumentohet pabarazia e krijuar mes profileve të profesioneve me paga të mesme të ulta, por që kanë qëndruar pjesë të listepagesave të tatimpaguesve dhe profesionistëve që kanë zgjedhur të shmangin tatimin mbi të ardhurat nga punësimi atëherë mund të ndërtojmë përsëri linja paragjykimi për të gjithë shtresën e profesionistëve të lirë, duke ndërtuar politika fiskale për të shmangur supozime ndaj të cilave nuk ka asnjë hetim të thelluar që janë kryer realisht këto shmangie.

Pra me këtë formë po ndërtojmë një ligj mbi baza aludimesh dhe paragjykimi që prek një shtresë të tërë duke krijuar pabarazi. Një nënshkrim taksativ që deri në vitin 2029 norma tatimore mbi fitimin do vazhdonte të ishte 0 për biznesin e vogël dhe për kategorinë e profesioneve të lira duket që nuk është mbajtur duke u kthyer në parim që shteti duhet të tatoj çdo burim të ardhurash pavarësisht madhësisë së biznesit.



15% TATIM MBI FITIM

Risitë e që sjellin dispozitat e reja ligjore

Ligji i ri i tatimit mbi të ardhurat sjell disa risi të cilat vlejnë të argumentohen për efektet që krijojnë mbi subjektet që i nënshtrohen atyre dhe mbi normat e reja që saksionojë.

Risia kryesore është rikategorizimi i normave tatimore për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar, pjesë të kësaj kategorie edhe profesionet e lira duke e ndarë tashmë në dy fasha të tatueshme fitimin neto të subjektit. Këto kategori të subjekteve taten sipas normave respektive të paraqitura në Tab.1

Tab.1 Tatimi mbi të ardhurat për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit

Fitimi Neto	Norma tatimore
Deri në 14 milionë lekë	15%
Mbi 14 milionë lekë	23%

Burimi: Ministria e Financave

Pra për subjektet me të ardhura neto më të ulëta se 14 milionë lekë, barra tatimore është shtuar me 15% nga vendimmarrja e mëparshme për ta mbeshtetur këtë shtresë me normën tatimore 0%. Kjo strukturë e re ka norma tatimore më të larta se sa detyrimet tatimore për një të punësuar, prandaj nuk mund të konkludojmë që është një politikë mbështetëse dhe njëkohësisht rregulluese për këtë kategori. Ndërkohë do të vijojë të mbetet në fuqi tatim fitimi zero për qarkullimin deri në 14 milionë lekë për të gjithë ato biznese që nuk ofrojnë shërbime profesionale apo që operojnë në fushën e aktiviteteve tregtare, i cili do të rrijë në fuqi deri në vitin 2029.

Një strukturim tatimor është bërë edhe mbi tatimin për të ardhurat nga punësimi. Në përcaktimin e bazës tatimore duhet të aplikohen zbritje mbi baza vjetore ose mujore, për të llogaritur kështu shumën e tatueshme. Gjithashtu ligji parashikon që mund të aplikohen zbritje prej

48 mijë lekë nga baza e tatimit të punëmarrësit për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç si dhe zbritje 100 mijë lekë për arsimin e çdo fëmije në ngarkim. Normat tatimore përcaktohen sipas shtresëzimit të paraqitura në Tab.2.

Tab.2 Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi

E ardhura nga punësimi		Norma tatimore
Në Bazë Vjetore	Në Bazë Mujore	
Deri në 2 040 000	Deri në 170 000	13%
Mbi 2 040 000	Mbi 170 000	23%

Burimi: Ministria e Financave

Nëse një i vetëpunësuar, 80 % të të ardhurave bruto (të ardhurat e arkëtuara) i siguron nga 1 klient i vetëm, apo 90 % të të ardhurave bruto (të ardhurat e arkëtuara) nga më pak se 3 klientë, për qëllime të llogaritjes së detyrimit tatimor mbi të ardhurat neto (të ardhura të arkëtuara minus shpenzimet e zbritshme të biznesit) vjetore/mujore të tij, do të aplikohen normat e tatimit mbi pagën. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, llogaritja e detyrimit tatimor, sipas këtij paragrafi, do të bëhet nga vetë i vetëpunësuarit që plotëson këto kritere, në deklaratën tatimore vjetore të tij. Në rastet kur të ardhurat që përfitohen sipas këtij paragrafi, paguhen rregullisht çdo muaj, llogaritja e tatimit nga vetë i punësuarit bëhet në bazë mujore. Nëse kontratat ndërmjet të vetëpunësuarit dhe të porositesit të shërbimit janë vjetore, por pagesa bëhet me këste, p.sh. dy apo tri herë në vit, e ardhura e përfituar shtrihet për të gjitha periudhat tatimore të cilave u takon (muajt) dhe tatimi llogaritet sipas shumës së të ardhurës së çdo muaji. Ndërkohë për efekt të deklarimit të të ardhurave nga biznesi, kjo e ardhur do të deklarohet zero në deklaratën e të ardhurave personale nga biznesi, duke qenë se kjo e ardhur konsiderohet e ardhur nga punësimi. Ndërsa në rastet kur i

vetëpunësuar, rezident tatimor me seli të përhershme në Shqipëri, siguron 100 për qind të shërbimeve vetëm për persona jorezidentë, të cilët nuk kanë seli të përhershme në Shqipëri në formën, degës apo zyrës së përfaqësimit do të trajtohet sipas normave tatimore që sanksionohen për individët tregtar dhe të vetëpunësuarit.

Në mbështetje të një politike të re sa i takon derdhjes së kontributeve në skema private pensioni është sanksionuar në ligj se kjo mund të ndikojë të zvogëlimin e bazës së tatueshme, apo thënë ndryshe shuma mbi të cilën llogaritet tatimi. Për efekt tatimi, çdo kontribut i bërë nga çdo anëtar i një fondi privat pensioni, i zbritet nga të ardhurat personale deri në kufirin maksimal të pagës minimale.

Këto politika të reja fiskale ndryshojnë detyrimet tatimore për një pjesë të subjekteve tatimpaguese. Kjo rrjedhimisht është shoqëruar me një periudhë tranzitore ku subjektet deklaruese kanë shprehur shqetësimin për paqartësitë implementuese të ndryshimeve ligjore dhe mungesës së udhëzimeve konkrete për këtë ristrukturim.

Duhet theksuar gjithashtu se argumentimi i ndryshimeve të normave tatimore është i pabazuar në gjetje dhe shifra, duke mos u shoqëruar me raste shqyrtimi të shmangieve tatimore nga subjektet tatimpaguese, pra me mungesë ekspertize, por duke ngritur ndryshime ligjore mbi përceptime lidhur me tregun. Një praktikë e tillë lë hapësira për spekulime mbi vendimmarrjen ligjore.

Këto ndryshime ligjore krahas të tjerave kanë sjellë edhe një sërë zhvillimesh të reja në fushën e tatimit ndërkombëtar dhe në të njëjtën kohë ofrojnë disa lehtësira për korporatat:

- Zgjatja e periudhës së mbartjes së humbjeve: Kalimi nga një periudhë 3-vjeçare në një periudhë 5-vjeçare për të mbartur humbjet e shkaktuara lehtëson korporatat duke i lejuar ato të shfrytëzojnë humbjet në një periudhë më të gjatë për të zvogëluar detyrimet tatimore.
- Thjeshtimi dhe lehtësimi i shpenzimeve afatgjata: Përdorimi i amortizimit lineari individual për grupet e pajisjeve dhe softuerit/harduerit redukton

ngarkesën administrative dhe lejon korporatat të reduktojnë barrën tatimore.

- Rregullat e taksimit për kontratat afatgjata: Njohja e rregullave specifike për kontratat afatgjata sjell një qasje më të qartë dhe të drejtë përkatësisht në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e tyre.
- Rregullat për riorganizimet e biznesit dhe transferimin e aktiveve: Rregullat e qarta në këtë drejtim ndihmojnë në lehtësimin e proceseve të riorganizimit dhe transferimit të pasurive të biznesit pa ndikuar në shkallën e detyrimeve tatimore.
- Njohja e zbritshme të vlerës së mbetur të një aktivi jashtë qarkullimit: Ky përjashtim mund lehtësojë koston tatimore për korporatat duke u lejuar atyre të zvogëlojnë bazën tatimore.
- Rregullat transparente për borxhin e keq: Vendosja e rregullave transparente për trajtimin e borxhit të keq sjell siguri dhe stabilitet për korporatat në lidhje me këtë aspekt tatimor.
- Rregullat e përgjithshme për alokimin dhe kufijtë e interesave të kredihënies: Kjo përfshin rregullat e qarta për trajtimin e interesave të paguara ose të marrura nga korporatat, duke siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të ndershme në lidhje me këtë çështje.

Këto indikatorë favorizues mund t'i vijnë në ndihmë subjekteve në uljen e barrës tatimore, por mund të shërbejnë edhe si hapësira ligjore për të përfituar në shmangien e detyrimeve tatimore, duke shfrytëzuar këto lehtësi, të cilat janë në përputhje me ligjin e miratuar.

Për personat fizikë, individ tregtar apo individ të vetëpunësuar me një qarkullim vjetor deri në 10,000,000 lekë, kanë të drejtë të zgjedhin një nga metodat për njohjen e shpenzimeve të zbritshme. Ato mund të zgjedhin të pranojnë një regjim të veçantë, nëpërmjet të cilit shpenzimet e supozuara zbriten paraprakisht sipas shumave të caktuara:

- 60% të të ardhurave për veprimtaritë prodhuese;
- 90% të të ardhurave për veprimtaritë e tregtimit me shumicë;
- 70% të të ardhurave për veprimtaritë e tregtimit me pakicë të mallrave dhe transportit individual;

- 60% të të ardhurave për veprimtaritë bare, restorante, disko, etj.;
- 50% të të ardhurave për veprimtaritë e shërbimeve, veprimtaritë artizanale dhe veprimtaritë zejtare;
- 30% të të ardhurave për individët e vetëpunësuar;

Në të kundërt do të bëhet përlogaritja e shpenzimeve të zbritshme bazuar në dokumentacionin dhe faturat për çdo shpenzim.

Efektet e ndryshimeve mbi detyrimet tatimore

Ndryshimet e normave tatimore rrjedhimisht janë shoqëruar edhe me ndryshime të detyrimeve tatimore të tatimpaguesve, qofshin ato me të ardhura nga punësimi apo edhe ato nga vetëpunësimi apo individët tregtarë.

Referuar analizës krahasuese rezulton se për individët tregtarë, të vetëpunësuarit, ku gjithashtu përfshihen dhe lista e miratuar e profesioneve të lira, me të ardhura nën 14 milionë lekë, do të paguajnë 15% detyrime tatimore më shumë. Kjo është një barrë tatimore shtesë që prekë një shtresë të këtyre bizneseve që 2 vite më parë u mbështetën me lehtësime fiskale duke u vendosur norma tatimore 0%. Gjithashtu edhe po të krahasojmë normat tatimore të të ardhurave nga punësimi rezulton përsëri se profesionet e lira do të paguajnë më shumë detyrime tatimore.

Me dispozitat ligjore të mëparshme një i vetëpunësuar paguante 7 herë me pak detyrime tatimore dhe kontribute se një i punësuar. Kjo kosto e re që lind detyron këto subjekte të përshtaten me normativat e reja ligjore, një ndryshim thelbësor me situatën e mëparshme.

Vendosja e normave tatimore të këtilla për të vetëpunësuarit mund të cilësohet e nxituar duke njohur se sa pak i rregulluar është ky treg dhe sa i painformuar është ai. Marrim rastin e një personi fizik i cili ofron shërbim dhe ka një qarkullim vjetor deri në 10,000,000 lekë, të cilit do t'i zbriten 30% e shpenzimeve të supozuara ose faturat e blerjes të cilat i kanë jo të shpeshta, do t'i çonte këta të fundit në mosdeklarimin e plotë të faturave të shitjes nga ana e tyre, pra do të shikonin mundësinë e përfitimeve financiare nën dorë, kjo për të ulur pagesën e të ardhurave

të tatueshme të mbetura pas zbritjes së shpenzimeve. Por edhe në rastin kur personi fizik do t'i deklaronte tërësisht faturat e shitjes së lëshuara prej tij, normalisht me shtimin e këtij tatimi, ose do të rriste çmimet e shërbimeve të ofruara prej tij, ose do të alternonte mënyrën e pagës nën dorë. Pra në këtë formë kjo lloj politike do nxiste evazionin fiskal.

Normat e reja tatimore detyrojnë profesionet e lira të rrisin tarifatat e shërbimeve të tyre nga 15% deri në 100% dhe kjo rrjedhimisht shoqërohet me rritjen e kostove për bizneset që marrin shërbime prej tyre. Kjo mund të pasohet me rënien e të ardhurave të bizneseve, ku disa mund të rrezikojnë edhe falimentin dhe kjo mund të rrisë njëkohësisht papunësinë dhe varfërinë.

Konstatohet rritje e tarifave të shërbimeve të psikologëve pranë gjykatave si dhe në shërbimet mjekësore të ofruara në disa klinikave private. Kontrollat mjekësore me tarifë 1,000 lekë janë shtrenjtuar në 2,000 lekë. Kontrollat me tarifë 3,000 lekë janë rritur në 4,000 lekë dhe vizitat mjekësore prej 4,000 lekë kanë arritur në 5,000 lekë. Profesionet e tjera të lira si kontabilistët dhe avokatët parashikojnë gjithashtu rritje të tarifave të shërbimeve të tyre përgjatë këtij viti. Pra nga këto të dhëna dhe ky trend kuptohet se rritja e normave tatimore do të çojë rrjedhimisht në rritje të tarifave duke rënduar edhe më shumë marrësit e shërbimeve, një çark ky i mbyllur ku gjithmonë disfavorizohet konsumatori final.

Ndryshe mund të paraqitet situata me ristrukturimin e përllogaritjes së detyrimeve tatimore për tatimpaguesit me të ardhura nga punësimi. Duke u shtuar modalitetet e zbritjeve vjetore apo mujore në përcaktimin e bazës së tatueshme, gjithashtu edhe me rritjen e nivelit të pagës së patatueshme nga 40,000 lekë në 50,000 lekë në muaj, kjo do ndikojë pozitivisht për disa profile tatimpaguesish. Referuar të dhënave të marra nga Ministria e Financave janë 65 mijë individë të cilët përfitojnë nga kjo lehtësi, të cilët është përllogaritur se do të paguajnë 15,700 lekë detyrime tatimore më pak në vit. Kjo mund të cilësohet si një nismë pozitive për ulur barrën tatimore për individët me të ardhura nga



15% TATIM MBI FITIM

punësimi më të ulëta dhe për këtë ka ndikuar sidoemos rritja e pragut të patatueshëm.

Gjithashtu në po të njëjtën kategori, pra tatimpagues nga të ardhura nga punësimi, një tjetër profil është përfitues i ndryshimeve të reja skematike. Kategoria e tatimpaguesëve me të ardhura nga punësimi në fashën 50-60 mijë lekë, të cilëve me skemën e vjetër nga 30 mijë lekë që ishte e ardhura e tatueshme me 0%, tashmë u njihet një zbritje tatimore prej 35 mijë lekësh në muaj, duke lehtësuar barrën tatimore për 44 mijë individë me 7,800 lekë në vit.

Këto ndryshime janë një mbështetje për këtë shtresë të përfituesve duke i lënë më shumë të ardhura në menaxhimin vetjak të tyre. Duke iu referuar edhe të dhënave nga Instituti i Statistikave ku nënvizohet se familjet shqiptare shpenzojnë 41% të të ardhurave të tyre mujore për konsum ushqimor. E parë në këtë këndvështrim kjo politikë mund të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e treguesve të konsumit duke iu referuar edhe shifrave të inflacionit për kategorinë "Ushqime dhe pije jo-alkolike", të cilët kanë treguar rritje mesatarisht 7% krahasuar me një vit më parë.

Akti Normativ që ndryshoi zbatimin e ligjit

Duket se gjendur në një situatë të vështirë të zbatueshmërisë së teknikaliteteve të sanksionuara në ndryshimet ligjore, nëpërmjet një akti normative qeveria ka shtyrë periudhën e zbatimit të ligjit për një pjesë të rëndësishme të neneve nga 1 Janari 2024 që isht parashikuar në 1 Janar të vitit 2025. Cilësohet se vështirësitë kryesore lidhen më së shumti me modalitetet e formularëve të deklarimit të fitimeve, gjithashtu edhe për parapagimet specifike për kategorinë e të vetëpunësuarve që ofrojnë shërbime profesionale, njohur si kategoria e profesioneve të lira, të cilët bëhen subjekt i ligjit nga 1 Janari.

Në kushtet e pamundësisë teknike në zbatueshmërinë e ndryshimeve ligjore, nëpërmjet aktit normative të miratuar përcaktohen edhe elementët zbatueshmëria e të cilëve shtyhet për periudhën e ardhshme fiskale.

Në këto kushte për të gjithë tatimpaguesit, të regjistruar para datës 31 dhjetor 2023, të cilët janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi fitimin, si edhe për ata që regjistrohen për herë të parë në vitin pasardhës, për efekt të periudhës tatimore 2024, do të përdorin formularët dhe përgjegjësitë tatimore, sipas dispozitave ligjore të ligjit të tatimit mbi të ardhurat i vitit 1998 i ndryshuar dhe amenduar në vite. Pra do të vazhdojnë në të njëjtën formë deklarimi si para miratimit të ligjit.

Akti normativ gjithashtu thotë se për parapagimet, të përcaktuara sipas ligjit të ri për kategoritë e personave, të cilët furnizojnë shërbime profesionale dhe janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga data 1 janar 2024, përjashtimisht për vitin 2024, llogariten bazuar në deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimit mbi fitimin të viteve paraardhëse, duke zbatuar normat tatimore të parashikuara në këtë ligj.

Edhe deklarimit të tatimit të mbajtur në burim do të zbatohet duke filluar nga periudha tatimore janar 2025 me formularët e rinj. Për vitin 2024 akti normativ përcakton se do të përdoret deklaratat për tatimin e mbajtur në burim sipas modelit ekzistues të formularëve.

Llojet e pagesave për të cilat mbahet tatimi në burim, përfshin pagesat për interesat bankare dhe institucione të tjera financiare, pagesat nga honorarët, nga qiraja e individëve, për çdo pagesë të përfituar nga lojërat e fatit dhe kazinotë, pagesa për performancën e muzikantëve në koncerte etj.

Për të vetëpunësuarit e profesioneve të lira tatimi progresiv nga 15% deri në 23% do të nisë zbatimin nga 1 janari 2024, ndërsa për biznesin e vogël (duke përfshirë kategoritë të vetëpunësuarit) efektet e ligjit do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2029.

Referuar aktit normativ dhe vendimmarrjes që ai ka përcaktuar, qeveria njëherazi ka shtyrë edhe përfitimet për kategoritë e sipërpërmendurane këtë raport të tatimpaguesve me të ardhura nga punësimi duke shtyrë zbatueshmërinë si të zbritjeve vjetore apo mujore, zbritjeve për arsimimin e fëmijëve nën 18 vjeç, por edhe të fashave për përcaktimin e normave

tatimore. Normat tatimore do të hyjnë në fuqi në 1 Janar 2024 për të vetëpunësuarit e profesioneve të lira të cilët ishin edhe subjektet e reja të këtij ligji.

Kjo situatë dhe mungesa e transparencës në proces kanë ndikuar në paqartësi të vetë specialistëve, por edhe të subjekteve lidhur me afatet dhe modalitetet mbi të cilat do të zbatohet ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat.

“Profesionet e lira”, të varurat e programeve politike

Profesionet e lira janë kategoria e tatimpaguesve të cilët janë subjektet e reja të tatimit mbi të ardhurat duke u normuar me nivele të reja tatami. Përmes ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” të vetëpunësuarit e profesioneve të lira nuk do të trajtohem më si biznes i vogël me 0%, por të ardhurat neto (fitimi) nga biznesi, pas shpenzimeve të zbritshme, të vetëpunësuarit do të taten me normat 15% dhe 23% sipas fashave të sanksionuara në ligj.

Sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) do të paguajnë deri 50% më pak tatim se të punësuarit, ndërsa norma tatimore 23% për kategorinë me të ardhura vjetore mbi 14 milionë lekë barazohet me normën tatimore që paguajnë shoqëritë tregtare (15% mbi fitimin dhe 8% tatim dividendi). Në të vërtetë profesionet e lira do të taten 15% më shumë se një vit më parë ku taten me normën 0%. Pra nuk qëndron një bazë krahasimore mes të vetëpunësuarve dhe të punësuarve më të ardhura nga punësimi. Ky ndryshim vjen dy vite pas mandatimit të programit qeverisës që profesionet e lira do i trajtonte me të njëjtën formë si biznesin e vogël.

Referuar sqarimeve të marra nga Ministria e Financave sqarohet se norma tatimore 23% do të frenojë lëvizjen e biznesit drejt fashave të tjera me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.

Në fakt e cilësuar edhe nga ekspertët kjo kategori do të ngarkohet me tatimin mbi të ardhurat më shumë se korporatat dhe bizneset e vogla që do të vijojnë ta kenë zero tatim deri në vitin 2029. Ky ligj dëmton mbi

të gjitha shtresën e mesme e cila ka zgjedhur të qëndrojë e pavarur nga strukturat e punësimit në ofrimin e shërbimit të saj.

Vendimi me listën për profesionet e lira, i botuar në Fletoren Zyrtare, është e ndarë në 26 lloje aktivitesh, në 262 profesione, sipas llojit të aktivitetit. Në listën e profesioneve të lira do të përfshihen aktivitetet e shërbimeve të IT, të kontabilitetit, avokatët, arsimit, mjekët, pasuritë e paluajtshme, agjencitë e lajmeve, agjencitë e punësimit, të sportit, operatorët turistikë etj.

Ky rikategorizim sjell mungesë barazie në trajtimin që i bëhet bizneseve duke krijuar standarte të dyfishta për natyra të njëjta apo të ngjashme biznesi. Ndryshimi në këto dy vite nga programi qeverisës deri në vendimin e tatimit me normat 15% dhe 23% për profesionet e lira mund të cilësohet paqëndrueshmëri në politikat fiskale, gjë e cila e dëmton biznesin, sidoemos atë të vogël. Biznese të vogla të cilat mund të jenë nxitur nga normat e tatimit zero për të hapur një biznes sot e gjejnë veten në një tjetër situatë e cila mund të kthehet si një politikë demotivuese për hapjen e kësaj natyre biznesi.

Referuar të dhënave projektohet se efektet buxhetore nga këto ndryshime arrijnë deri në 30 milionë dollar, e thënë ndryshe 0.4% e buxhetit të shtetit. Këto efekte janë minimaliste, kur dëmet që kanë shkaktuar në klimën e biznesit janë shumë herë me të mëdha.

Ndikimi i dispozitave të reja ligjore në numrin e të vetëpunësuarve

Ndryshimet ligjore janë shoqëruar gjithashtu edhe me ndryshime në numrin e individëve dhe entiteteve të cilat bëhen subjekte të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.


Referuar të dhënave nga Ministria e Financave parashikohet që me ndryshimet ligjore të kryera, subjekte të këtij ligji do të jenë 35 mijë individë edhe entitete që do i nënshtrohen normave 15% dhe 23% sipas fashave përkatëse. Kjo shifër e parashikuar është afro dyshfishi i asaj të proklamuar më parë, ku efektet mendohej se do shtriheshin për 16 mijë të vetëpunësuar, pjesë e profesioneve të lira. Pra ky ligj prek një spektër

më të gjerë, duke shtuar njëkohësisht barrën fiskale të tij për më shumë biznese.

Numri i të vetëpunësuarve ra në nivelin më të ulët që prej 2015-s në tremujorin e dytë të vitit 2023 dhe kjo mund të cilësohet si një tregues i rëndësishëm për ekonominë dhe strukturën e punësimit në vend. Pavarësisht kësaj të vetëpunësuarit përbëjnë ofuesin më të madh të punës në vend, duke zënë kështu pjesën më të madhe në strukturën e punësimit.

Referuar të dhënave të marra nga INSTAT tregojnë se për herë të parë, shifra e personave që janë regjistruar si të vetëpunësuar ka rënë nën 29.3 për qind. Ky trend në rënie ka nisur që në tremujorin e tretë të vitit 2022, kur kjo kategori zinte 32% të totalit. Kjo rënie dëshmon për një ndryshim të trendit në përbërjen e strukturës së punësimit.

Fig.1 Përqindja e të vetëpunësuarve në punësimin gjithsej



Burimi: Revista "Monitor"

Kjo situatë përshkruan një trend të konsolidimit të bizneseve të mëdha në disa sektorë, duke lënë një impakt të ndjeshëm mbi bizneset e vogla, sidomos ato të shitjes me pakicë dhe të shërbimeve si ushqimoret dhe kafenetë e lagjeve. Kjo mund të jetë e vështirë për bizneset e vogla për t'i mbijetuar konkurrencës së madhe dhe të mbajnë përballë kostot e

tyre. Si rrjedhojë, disa prej tyre mund të jenë të detyruar të mbyllen ose të ndërrojnë modelin e tyre të biznesit.

Shumica e atyre që punojnë pa pagë janë të vetëpunësuar në biznese familjare ose në biznese të vogla. Kjo tregon për rëndësinë e sektorit të vogël dhe të mesëm të biznesit për punësimin dhe ekonominë vendase. Ndërkohë, nevojitet të krijohet mjedis të favorshëm për këta biznesë për të mbijetuar dhe për të rritur kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo klimë biznesi e favorshme për këtë kategori kërcënohet tashmë nga ndryshimet ligjore, ku barra detyruese tatimore do të shtohet.

Një trend rënës të kategorisë së të vetëpunësuarve ka edhe në vendet e BE, ku sipas të dhënave të Eurostat, vetëpunësimi ka rënë nga 10.2% në vitin 2010, në 8.9% në vitin 2021. Ndër vendet anëtare të BE-së, Greqia (16%), Polonia dhe Italia (të dyja 15%) kishin përqindjet më të larta. Shqipëria duket që ka një normë më të lartë për këtë kategori se mesatarja e BE, por edhe nga vende të Ballkanit Perëndimor si Serbia që kjo kategori përbën 16% të të gjithë punëtorëve.

Vetëpunësimi i personave të varur ekonomikisht ishte më i zakonshëm në Shqipëri (11%), Kosovë (5%) dhe Serbi (4%).

Ndryshimet ligjore dhe konfuzionet lidhur me zbatueshmërinë, por edhe normat e larta të vendosura na lënë premisat të parashikojmë se trendi rënës mund të vazhdojë, duke qënë se tashmë normat e ulëta tatimore nuk janë një nxitës për të hapur dhe mbajtur një biznes sidomos të kësaj kategorie.

Ndryshimet ligjore në këndvështrimin e subjekteve

Shpejtësia me të cilën ligji u miratua, paqartësitë që krijoi nuk i lanë kohë subjekteve të raportojnë ndryshimet ligjore dhe të arrijnë të shprehin kundërshtimet e tyre lidhur me to. Nisur edhe nga dispozitat kalimtare të cilat shtojnë zbatueshmërinë për pjesën kryesore të ndryshimeve për



15% TATIM MBI FITIM

periudhat tatimore në vazhdim, mbetet të themi se të prekurit e vëtëm janë të vetëpunësuarit, individët tregtarë dhe profesionet e lira.

Për të marrë opinionin, këndvështrimin e tyre, kundërshtimet që kanë me zhvillimet e fundit si dhe mbi format si janë informuar kemi zhvilluar intervista cilësore me 5 subjekte që i përkasin kategorisë së profesioneve të lira.

Subjektet e intervistuarra vijnë nga profile të ndryshme dhe kanë kohëzgjatje të ndryshme në treg që varion nga 1 deri në mbi 3 vite. Kemi bërë këtë përzgjedhje për të patur një panoramë më të qartë dhe gjithëpërfshirëse duke u fokusuar edhe te subjektet aktive para vitit 2021, vit në të cilin u vendosën normat tatimore 0%.

Dy nga subjektet e intervistuarra kanë më pak se tre vite që kanë nisur aktivitetin e tyre dhe theksojnë se janë nxitur nga vendimmarrja e vendosjes së tatimit 0% deri në vitin 2029, si një periudhë kohore e mjaftueshme për të krijuar stabilitet financiar. Ato shprehen se kjo vendimmarrje e re që i bën pjesë të fashave tatimore i ka bërë të rikosiderojnë vazhdimësinë e subjekteve të tyre. Këto subjekte karakterizohen gjithashtu edhe nga fakti që janë hapur nga të rinj, si një mundësi që të zhvillonin aftësitë e tyre.

Të gjitha subjektet e intervistuarra shprehen se nuk kanë informacion lidhur me format se si do të implemtohen ndryshimet ligjore. Njëi nga ato shprehet: "Nuk kemi asnjë informacion të saktë, madje edhe profesionistët janë të paqartë me mënyrën se si do të procedohet". Kjo ka ardhur edhe nga mungesa e sesioneve informuese dhe simdomos nga mungesa e sioneve degjimore me palët e interesuara para miratimit të ligjit duke mos i bërë ato pjesë të procesit. Të gjithë të intervistuarit shprehen se nuk janë informuar për këto sesione diskutimi paraprake, madje nuk kanë informacion që grupe përfaqësuese të tyre të jenë përfshirë gjithashtu në proces.

Ato shprehen të braktisur dhe i cilësojnë si skandaloze ndryshimet ligjore duke u nisur nga premtimet e marra që deri në vitin 2029, nuk do të tatoheshin. Njëri nga subjektet kur është pyetur se si i gjykon ndryshimet

ligjore është shprehur: “Shumë negative, madje kam konsideruar ta pezulloj aktivitetin”. Një tjetër shprehet se këto politik të reja do nxisin rritjen e nformalitetit në treg. Këto të marra së bashku dëshmojnë për një klimë jo të mirë të të bëit biznes, ku po konsiderohet edhe mbyllja e aktiviteve nga ato të cilët kanë më shumë se 3 vite në treg.

Ekspertët dhe subjektet e ligjit shprehen se janë kundër këtyre ndryshimeve si një formë që nxit dhe thellon pabarazinë, gjithashtu si një politikë që nuk ndihmon inicimin e nismave të reja në botën e biznesit. Këto intervista na shërbyen për të kuptuar realitetin se si vetë subjektet i konsiderojnë këto ndryshime dhe qasjen që ato do të ndjekin duke qënë që ligji tashmë është miratuar.



15% TATIM MBI FITIM

Gjetjet kryesore

- Referuar Ministrisë së Financave argumentohet se arsyet reale të cilat çuan në ndryshimet e fundit ligjore lidhen me dukurinë e “erozionit” të listëpagesave të tatimpaguesve për kategoritë që bëjnë pjesë në ato që cilësohen si profesione të lira.
- Problematika evidente në sistemin fiskal shqiptar vazhdon të mbetet evazioni, kjo e nënvizuar edhe në raportin e publikuar të Departamentit të Shtetit për vitin 2023.
- Subjektet me të ardhura neto më të ulëta se 14 milionë lekë që i përkasin kategorisë të vetëpunësuar, individ tregtar dhe profesione të lira, barra tatimore është shtuar me 15% nga vendimmarrja e mëparshme, e cila e mbështeste këtë shtresë me normën tatimore 0%.
- Në përcaktimin e bazës tatimore duhet të aplikohen zbritje mbi baza vjetore ose mujore, për të llogaritur kështu shumën e tatueshme, ku gjithashtu ligji parashikon që mund të aplikohen zbritje prej 48 mijë lekë nga baza e tatimit të punëmarrësit për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç si dhe zbritje 100 mijë lekë për arsimin e çdo fëmije në ngarkim.
- Nëse një i vetëpunësuar, 80 % të të ardhurave bruto (të ardhurat e arkëtuara) i siguron nga 1 klient i vetëm, apo 90 % të të ardhurave bruto (të ardhurat e arkëtuara) nga më pak se 3 klientë, për qëllime të llogaritjes së detyrimit tatimor mbi të ardhurat neto (të ardhura të arkëtuara minus shpenzimet e zbritshme të biznesit) vjetore/mujore të tij, do të aplikohen normat e tatimit mbi pagën.
- Për personat fizikë, individ tregtar apo individ të vetëpunësuar me një qarkullim vjetor deri në 10,000,000 lekë, kanë të drejtë të zgjedhin një nga metodat për njohjen e shpenzimeve të zbritshme, ose ato të njohura në fatura ose normat fikse të përcaktuar anë ligj.
- Me dispozitat ligjore të mëparshme një i vetëpunësuar paguante 7 herë me pak detyrime tatimore dhe kontribute se një i punësuar.



15% TATIM MBI FITIM

- Konstatohet rritje e tarifave të shërbimeve të psikologëve pranë gjykatave si dhe në shërbimet mjekësorë të ofruara në disa klinikave private, si dhe në profesionet e juristëve dhe kontabilistëve.
- Referuar të dhënave të marra nga Ministria e Financave janë 65 mijë individë të cilët përfitojnë nga rritja e nivelit të patatueshëm të pagave, të cilët është përlogaritur se do të paguajnë 15,700 lekë detyrime tatimore nga punësimi më pak në vit.
- Kategoria e tatimpaguesëve me të ardhura nga punësimi në fashën 50-60 mijë lekë, të cilëve me skemën e vjetër nga 30 mijë lekë që ishte e ardhura e tatueshme me 0%, tashmë u njihet një zbritje tatimore prej 35 mijë lekësh në muaj, duke lehtësuar barrën tatimore për 44 mijë individë me 7,800 lekë në vit.
- Referuar të dhënave nga Ministria e Financave parashikohet që me ndryshimet ligjore të kryera, subjekte të këtij ligji do të jenë 35 mijë individë edhe etnitete që do i nënshtrohen normave 15% dhe 23% sipas fashave përkatëse.
- Referuar të dhënave të marra nga INSTAT tregojnë se për herë të parë, shifra e personave që janë regjistruar si të vetëpunësuar ka rënë nën 29.3 për qind në strukturën e punësimit.
- Në intervistat cilësore të realizuara me subjekte në kategorinë profesione të lira konkludojmë se këto subjekte janë të painformuar, të pa përfshirë në procesin e diskutimit të ndryshimeve ligjore dhe të rrezikuar se kjo vendimarrje mund t'i detyrojë të pezullojnë aktivitetin.
- Konstatojmë që ligji i ri do të ndikojë në rritjen e informalitetit, evazionit fiskal dhe parasë së zezë.
- Referuar të dhënave projektohet se efektet buxhetore nga këto ndryshime arrijnë deri në 30 milionë dollar, e thënë ndryshe 0.4% e buxhetit të shtetit.



15% TATIM MBI FTIM

Rekomandime

- Ndryshimet ligjore në ligjin për tatimin mbi të ardhurat duhet të ishin ndërmarrë pas një konsultimi të gjerë me aktorët e biznesit dhe subjektet e reja të ligjit.
- Nisur nga mungesa e theksuar e informacionit si të subjekteve, por edhe të organeve përgjegjëse për zbatueshmërinë duhen ndjekur trajnime për stafet dhe sesione informuese për subjektet e ligjit mbi procedurat e reja se si do të implementohen ndryshimet ligjore.
- Në kategorinë të vetëpunësuar, individë tregtar, profesione të lira duhej vendosur një fashë e patatueshme sipas analizës së tregut për t'i ardhur në ndihmë subjekteve me xhiro të ulët.
- Ndryshimet ligjore nuk duhet të jenë kaq të shpeshta pasi afektojnë një masë të gjerë subjektsh dhe krijojnë paqëndrueshmëri financiare për to duke mos lejuar të krijojnë projeksione të qarta për bizneset e tyre në nivel afatmesëm.



15% TATIM MBI FITIM

Bibliografia

- Drafti i ri për tatimin mbi të ardhurat; nga 1 janari 2024 profesionet e lira do paguajnë deri 23% tatim, Monitor, (27.02.2023) [Drafti për ndryshimet ligjore të tatimit mbi të ardhurat](#)
- FLETORJA ZYRTARE, Ligj nr. 29/2023, PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023 me aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023) [Ligji për tatimin mbi të ardhurat](#)
- VENDIM Nr. 753, datë 20.12.2023 PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 29/2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR [VKM për dispozitat zbatuese të ligjit](#)
- UDHËZIM I PËRGJITHSHËM Nr. 26, datë 8.9.2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT [Udhëzim i përgjithshëm për tatimin mbi të ardhurat](#)
- Vetëpunësimi bie në 29.3%, niveli më i ulët që nga viti 2015, Monitor, (27.09.2023) [Numri i të vetëpunësuarve](#)
- Kuvendi miraton ligjin e ri “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (30.03.2023) [Ministria e Financave](#)
- Ekspertët: “Po goditet shtresa e mesme”, Monitor, (29.12.2023) [Viti i ri me taksa të reja për profesionistët e lirë, si po goditet shtresa e mesme](#)



15% TATIM MBI FITIM

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al